



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN
PRISHTINA” UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë,
Republika e Kosovës Tel:+381 38 244 183 ·
E-mail: rektorati@uni-pr.edu · www.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësi dhe Veterinari

Departamenti: - Bioteknologji në Zootekni

Programi i studimit: Shkencat e Aplikuara në Zootekni

NJOFTIM PËR DISKUTIM PUBLIK

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se:

Përmbledhja e shkurtër e temës master me titull:

“Niveli i ndotjes së ujit brenda fermës dhe ndikimi në disa tregues të rritjes në troftën ylberi (*Oncorhynchus mykiss*)”

i punuar nga kandidates Blerinë Hoti, ndodhet në diskutim publik 7 ditë duke filluar nga data 19.06.2024 deri me datë 25.06.2024.

Gjatë të njëjtës periudhë, në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nr 06-68 i datës 07. 05 2024 dorëzuar nga komisioni:

1. Prof. dr. Skender Muji kryetar
2. Prof. dr. Muhamet Kamberi Mentor - anëtar,
3. Prof. dr. Agim Rexhepi, anëtar,

Versionin e plotë të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte tek udhëheqësi shkencor i temës Prof. dr. Muhamet Kamberi, përmes e-mail adresës muhamet.kamberi@uni-pr.edu.

Komentet dhe sugjerimet janë të mirëpritura.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
DEPARTAMENTI- BIOTEKNOLOGJI NË ZOOTEKNI



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

Tema: Niveli i ndotjes së ujit brenda fermës dhe ndikimi në disa tregues të rritjes në troftën ylberi (*Oncorhynchus mykiss*)

Mentor
Prof. Dr. Muhamet Kamberi

Kandidatja:
Bsc. Blerinë Hoti

Prishtinë, Qershor 2024

Përmbledhje e punimit të temës master

Titulli I temës: “Niveli i ndotjes së ujit brenda fermës dhe ndikimi në disa tregues të rritjes në troftën ylberi (*Oncorhynchus mykiss*)”

Kandidatja: Bsc Blerinë Hoti

Mentori: Prof. dr. Muhamet Kamberi

Mishi i peshkut është një burim i proteinave dhe i lëndëve të tjera ushqyese thelbësore dhe konsumohet në mbarë botën. Mishi i peshkut është përgjithësisht i ulët në yndyrë dhe kalori, duke e bërë atë një zgjedhje më të shëndetshme në krahasim me llojet e tjera të mishit. Ka shumë lloje peshqish që konsumohen zakonisht, duke përfshirë salmonin, tonin, merlucin, troftën, dhe shumë lloje tjera. Trofta e ylberit zakonisht gjendet në mjedise të ftohta dhe të pastra me ujëra të ëmbla si lumenj, përrenj, liqene dhe rezervuarë. Ata kërkojnë ujë të oksigjenuar mirë dhe preferojnë temperatura midis 10 deri në 15°C.

Metodat të cilat janë përdorur gjatë hulumtimit janë: metoda përshkruese përmes së cilës janë bërë hulumtime nga literatura të marrura nga autorë të ndryshëm. Gjatë punimit gjithashtu janë përdorur metoda sasiore ku janë marr të dhëna mbi fermentat të cilat janë hulumtuar, si dhe janë marrë mostra analiza fiziko- kimike të ujit nga fermentat e troftës ylber (*Oncorhynchus mykiss*). Objekt studimi ishin 4 ferma të rrjedhjeve të ndryshme të ujit Lumë, Përrua, Pus dhe Sistem i ujitjes i shfrytëzuar për kultivimin e peshkut troftë.

Marrja e mostrave është bërë tri herë gjatë 3 muajve. Qëllimi është për të vlerësuar cilësinë e ujit përmes përcaktimit të lëndëve të tretura si: mesatarja e lëndëve të tretura (TDS: mg L), lëndët pezull (TSS, mg/l), turbiditeti (NTU), amoniaku total (TAN) Fofatet (mg l), nevoja biokimike për oksigjen (BOD5), Amoniaku (NH₃-N), Nitritet (NO₂-N), Nitratet (NO₃-N), Fosfori total (TP), Oksigjeni i tretur (mg/L), pH, Temperatura (°C), COD.

Në rezultatet e fituara gjatë analizave fiziko-kimike të ujit në ferma të peshkut, gjatë muajit Korrik, Gusht, dhe Tetor 2021, shihet se përgjatë gjithë muajve të vitit ndodhin ndryshime në aspektin fiziko-kimik. Këto ndryshime, pa mëdyshje vijnë si rezultat i aktivitetit të peshqve, burimit të ujit, reshjeve, thatësisë si dhe aktiviteteve tjera industriale apo edhe ato antropologjike.

Në rezultatet tona të fituara temperatura më e larta ishte në muajin e tretë te ferma e tretë 16.5 °C dhe me e ulëta në muajin tetor te ferma e katërt 8.7 °C.

Organizmat si trofta kërkojnë sasi të lartë të oksigjenit te tretur vlera më e lartë ishte 10,7 mg/l, kurse vlerat më të ulëta janë në dy vendmostrimet e fermës së tretë 3.5 mg/l, kjo për shkak se shfrytëzohen ujërat nëntokësorë për kultivimin e peshkut kur dihet që ujërat nëntokësorë zakonisht përmbajnë nivele më të ulëta të oksigjenit të tretur në krahasim me ujin sipërfaqësor të ajrosur mirë. Vlera e pH 7.3 - 8.1 pra ka qenë brenda vlerave të lejuara për kultivimin e peshkut. Trofta e ylberit mund të tolerojë një gamë të gjerë të temperaturave të ujit dhe variablave të tjera mjedisore, të tilla si cilësia e ujit, por ato kërkojnë ujë shumë të oksigjenuar dhe lulëzojnë në temperaturat e ujit prej 13-18° C. Nga hulumtimi ynë Ferma e tretë përdor ujë nga pusi për kultivimin e peshkut ujë i cili është më pak i oksigjenuar dhe temperatura më të larta, kështu që fermeri përdor sisteme shtesë për furnizim të mjaftueshëm te ujit me oksigjen.

Ndryshimi, rritja apo zvogëlimi i parametrave fiziko - kimik mund të ndikojë në rritje dhe zhvillimin e peshkut, mirëpo tek rezultatet tona përveç tek ferma e tretë ku disa nga vlerat janë më të ulëta, vlerat tjera janë brenda vlerave të lejuara për rritjen dhe kultivimin e peshkut.

Fjalët çelës: Akuakultura, Trofta ylberi, Parametrat fiziko-kimik